



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 112/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi, z. Goran Milenković - Referues, z. Blelrim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Botek” Sh.p.k-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me softver për testim elektronik të kandidatëve për patentë shofer (e-testimi)” me nr. prok. MI 16/003/111, iniciuar nga AK- /Ministria e Infrastrukturës/ më datën 18.05.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. Hedhet, si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik “Botek” Sh. p. k- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me softver për testim elektronik të kandidatëve për patentë shofer (e-testimi)” me nr. prok. MI 16/003/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Ministria e Infrastrukturës /.

II. Vërtetohet, njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së /Ministria e Infrastrukturës/, lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: “Furnizimi me softver për testim elektronik të kandidatëve për patentë shofer (e-testimi)” me nr. prok. MI 16/003/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Ministria e Infrastrukturës /.

III. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Botek” Sh.p.k-Prishtinë,- hedhet poshtë si e palejuar, i konfiskohet sigurimi i ankesës konform nenit 33.5 të rregullores së punës së OSHP-së, pasi që paneli konstaton se qëllimi i ankuesit ka qenë prolongimi i këtij aktiviteti të prokurimit.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:20.01.2016. Hapja e ofertave është bërë me dt:03.10.2016, ku kanë marr pjesë katër operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:07.04.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "PBC" Sh. p. k-Prishtinë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "Botek" Sh. p. k- Prishtinë me dt: 08.12.2016, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 09.12.2016 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, "Botek" Sh. p. k- Prishtinë

Operatori ekonomik ankues "Botek" Sh. p. k-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 14 Prill 2017 me nr. 112/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me softver për testim elektronik të kandidatëve për patentë shofer (e-testimi)" me nr. prok. MI 16/003/111, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "Ministria e Infrastrukturës" duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- *Neni 59 i LPP (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve),*

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 02. 05. 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18. 05. 2017, kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti e OSHP-së, Vëzhgues nga D Plus, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE z. Pallaska ka deklaruar: *"Së pari duhet sqaruar se ankesa është paraqitur në bazë të nenit 103 par. 1 , lidhur me nenin 103 par. 3 i Ligjit për Procedurë Administrative, i cili i jep autorizim organit administrativ që të shfuqizoj një vendim të vlefshëm juridik, por i cili është marr në bazë të fakteve gabuara – nën lajthim faktik apo juridik. Shtrohet pyetja si kemi ardhur deri këtu. Sa i përket vendimit të OSHP-së që është marr me 20. 01.*

2017, deri në atë datë “Botek” sh. p. k nuk ka pasur asnjë të dhënë lidhur me fituesin e këtij aktiviteti të prokurimit, kjo për faktin se AK-MI nuk i ka dorëzuar “Botek” sh. p. k dhe as nuk ka publikuar në faqe të KRPP-së njoftimin për dhënie të kontratës, siç kërkohet nga neni 41 i LPP-së”.

Më tutje përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: “Me datë 14. 02. 2017, “Botek” sh. p. k pas paraqitjes së kërkesës për qasje në dokumente të këtij aktiviteti të prokurimit, nga AK ka siguruar jo vetëm informatën për fituesin këtij aktiviteti por edhe dokumentet me cilat fituesi i këtij aktiviteti ka konkurruar. Me provën nga dokumentet e siguruara në këtë mënyrë “Botek” ka konstatuar që të gjitha autorizimet e prodhuesve MAF (gjithsej 4 sosh), janë lëshuar jo në emër të subjektit juridik që është pjesëmarrës në konzorciumin fitues por në emër të një subjekti tjetër juridik me numër biznesi tjetër. Ky konstatim vërtetohet me provat 4, 5, 6, 7 të bashkangjitura ankesës nr. 112/17 të dorëzuar në OSHP me datë 10.05.2017 si prova shtesë. Çka është me më rëndësi dhe po aq brengosëse është dokumenti të cilin fituesi i këtij aktiviteti e ka dorëzuar lidhur me procedurat gjyqësore që mund të zhvillohen kundër këtij subjekti juridik. Me këtë dokument numri i biznesit që është evidentuar nuk i përket subjektit juridik që ka fituar këtë aktivitet të prokurimit. Nga një hulumtim sipërfaqësor në regjistrin e bizneseve online, del që numri i biznesit të evidentuar në certifikatën e gjykatës i përket një biznesi individual që quhet “Gllareva NPT”. “Kjo mospërputhje krijon edhe dyshime lidhur me autenticitetin e certifikatë së gjykatës duke qenë që fonti i emrit të subjektit juridik që ka fituar këtë aktivitet të prokurimit është tërësisht i ndryshëm nga fonti i tekstit tjetër në po këtë certifikatë apo edhe fonti i certifikatave ngjashme të subjekteve tjera konkurruese. Këtë certifikatë së bashku me ekstraktet të regjistrit të biznesit janë dorëzuar si prova me shkresën e datës 10.05.2017. Për këto arsye është më se e qartë se janë plotësuar gjitha kushtet për revokimin dhe shfuqizimin vendimit të OSHP-së datës 20.01.2017, i cili është nxjerr në bazë të fakteve të pa qenë që janë prezantuar – kanë vënë në lajthitje OSHP-në. Këto fakte nuk kanë qenë të mundshme të dihen në momentin e nxjerrjes së vendimit të OSHP-së për shkak se objekt shqyrtimi i asaj anese ka qenë njoftimi për eliminimin e “Botek” si konkurrent në këtë proces, dhe jo njoftimi për dhënie të kontratës për subjektin konzorciumi i “PBC” sh. p. k. Përveç argumenteve të dhëna më sipër duhet theksuar që edhe procesi i nënshkrimit të kontratës është bërë në kundërshtim të plotë me nenin 26 par. 4. 1. kjo për shkak se AK-MI ka nënshkruar kontratën para se të nxjerr dhe publikoj njoftimin për dhënie të kontratës sipas nenit 41 të LPP-së dhe rrjedhimisht pa i mundësuar “Botek” apo palëve tjera të interesuara që ndaj njoftimit për dhënie të kontratës të paraqesin ankesë sipas dispozitave të LPP-së. Neni 26 par. 4. 1 të LPP-së parasheh qartë se një kontratë mund të nënshkruhet vetëm pasi që të ketë kaluar afati 10 ditorë nga data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës. Për arsye të dhëna më lart i propozojmë OSHP-së që jo vetëm të shfuqizoj vendimin e vet të mëparshëm por që të anuloj edhe njoftimin për dhënie të kontratës dhe kontratën e nënshkruar”.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-MI z. Bekolli deklaroj: “Unë nuk kam qenë pjesë e komisionit vlerësues në asnjë fazë të vlerësimit të këtij aktiviteti. Me sa di unë kontrata për këtë aktivitet të prokurimit veç është nënshkruar. Sipas autorizimit që kam për përfaqësim qëndroj pranë vendimit të AK-së”.

Eksperti Shqyrtues në seancë ka deklaruar: “Në raportin Kronologjik e dt: 05.05.2017, sipas autorizimit të pranuar më datën 02. 05. 2017, dhe në mbështetje të shkresave që patëm në posedim, ju njoftoj shkurtimisht me rrjedhën e procedurës. Autoriteti Kontraktues- Ministria e Infrastrukturës, më datën: 20.01.2016, ka publikuar njoftimin për kontratë në ueb- faqen e KRPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me softver për testim elektronik të kandidatëve për patentë shofer (e-testimi)”, me nr. të prokurimit: MI 16/003/111., duke aplikuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlera e madhe, ndërsa kriter për dhënie ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Kundër të njëjtit njoftim OE “BOTEK” sh. p. k, më datën 31.03.2016, kishte parashtruar ankesë pranë OSHP-së, me pretendimet ankimore se AK – Ministria e Infrastrukturës, kishte bërë shkelje të nenit 7, 53, dhe 108A, të LPP-së. Kundrejt të njëjtës ankesë, paneli shqyrtues më datën 11.05.2016, ka nxjerr vendim me nr. 79/16, gjegjësisht përmes pikës –I-, të dispozitivit ka aprovuar ankesën si pjesërisht të bazuar, ndërsa, përmes pikës –II-, ka obliguar, AK – MI, që për këtë aktivitet të prokurimit të bëjë zgjatjen e afatit për ofertim dhe të ndryshohen kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, konform rekomandimit të ekspertit teknik dhe të njoftohen palët në procedure me ndryshimet e dosjes së tenderit.

Pas vendimit të lartpërmendur, OE “PBC”, sh. p. k, më datën 02. 06. 2016, ka paraqitur ankese në OSHP, po ashtu kundër njoftimit për kontratë, me pretendimet ankimore se është bërë shkelje e nenit 7 dhe 57, të LPP-së, si dhe neni 26, i UOPP-së. Po ashtu paneli përsëri nxjerr vendim më datën 29.06.2016, me nr 168/16, gjegjësisht përmes pikës I, të dispozitivit të të njëjtit vendim ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën, ndërsa përmes pikës III, ka obliguar AK – MI, që për këtë aktivitet të prokurimit, përsëri të bëjë zgjatjen e afatit konform nenit 53.7, të LPP-së, dhe t'i njoftoj palët në procedurë me ndryshimet e dosjes së tenderit sipas arsytimit të të njëjtit vendim.

Pas vendimit të lartpërmendur OE “Botek”sh. p. k, përsëri kundër njoftimit për kontratë (ndryshimeve dhe zgjatjes së afatit), më datën 04.08.2016, parashtron ankesë pranë OSHP-së, me pretendimet ankimore se AK, nuk ka respektuar nenin 28 dhe 53, të LPP-së. Paneli shqyrtues, po ashtu përmes pikës I, të dispozitivit të vendimit të datës 01.09.2016, e aprovon ankesën, si të bazuar, ndërsa përmes pikës II, të të njëjtit vendim, obligon AK- MI, që për këtë aktivitet të prokurimit përsëri të bëhet zgjatja e afatit për ofertim dhe të ndryshohen kërkesat e dosjes së tenderi – specifikacionet teknike për pajisjen “Netëork Sëitches 2 copë”, sipas nenit 28, par 7, të LPP-së, dhe të njoftohen palët në procedurë me ndryshimet e mundshme.

Pas ankesave dhe vendimeve të lartë përmendura AK – MI, sipas procesverbalit të hapjes, më datën 03.10.2016, bënë hapjen e ofertave, ku sipas përshkrimit, ofertojnë gjithsej katër (4) operator ekonomik, rrjedhimisht AK, bënë vlerësimin e ofertave dhe rekomandon për dhënie të kontratës OE “PBC”sh. p. k.

Kundër të njëjtit rekomandim, gjegjësisht kundër arsytimit të eliminimit, OE “BOTEK” shpk, me datën 13.12.2016, parashtron ankese pranë OSHP-së, me nr. 460/16, me pretendimet ankimore se është bërë shkelje e nenit 59 të LPP-së, poashtu edhe OE “Tech Vision”, më datën 15.12.2016, paraqet ankese në OSHP, me pretendimet ankimore se gjatë vleresimit të ofertave është bërë shkelje e nenit: 1, 6, 7, 28, 56, 59, 60, 67, 69 dhe 71 të LPP-së.

Kundrejt ankesave të lartpërmendura paneli shqyrtues më datën 20.01.2017, nxjerr vendim dhe përmes pikës I. të dispozitivit hudhë si të pa lejuar ankesën e OE “BOTEK” shpk sipas përshkrimit, pasi që i njëjti OE nuk ka interes juridik material konform nenit 111, par 1.5 dhe 1.8, të LPP-se, perkitazi me nenin 4.26, ndërsa përmes pikes nr II. aprovon pjesërisht të bazuar ankesën e OE, NSH “Tech Vision & Edusoft & Neocom & Storm LLC & Safebit LLC”, ndërsa përmes pikës III, të të njëjtit vendim, vërteton vendimin e AK/ Ministria e nfracstruktues/, për dhënie të kontratës lidhur me

aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me softuer per testim elektronik te kandidateve per patent shofer (e-testimi)", me nr prok 16/003/111.

Ndërsa AK- Ministria e Infrastrukturës, më datën 07.04.2017, publikon njoftimin për dhënie të kontratës në ueb faqen e KRPP-së, me të rekomanduar OE "PBC".

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës OE BOTEK" shpk më datën 14.04.2017, parashtron ankesë në OSHP, me nr 112/17, me pretendimet ankimore se është shkelur neni 59 i LPP-së, gjegjësisht përmes deklaratës në të njejtën ankesë kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës të datës 07.04.2017, dhe lënda të kthehet në Ri-vleresim, duke përshkruar poashtu në formë kronologjike këtë aktivitet të prokurimit që nga njoftimi për kontratë deri në njoftimin për dhënie të kontratës, rrjedhimisht OE "BOTEK" sh. p. k, ankesës i ka bashkangjitur provat shkresore / kopjet e shkresave të pershkuara si më poshtë:

- Vendimi PSH.nr.79/16, i dates 11.05.2016
- Vendimi PSH.nr. 242/16, i dates 07.09.2016
- Procesverbali i hapjes së ofertave i datës 03.10.2016
- Letra standarde e tenderuesit të eliminuar,
- Fotografia e dosjeve të dorëzuara,
- Procesverbali i takimit gjatë qasjes,
- Raporti i ekspertizes i datës 06.01.2017.

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues deklaroj: "Qëndroj në tërësi pranë raportit kronologjik, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 04.05.2017".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se Operatori Ekonomik ankues nuk ka mundur të dëshmojë se ka interes juridik material në këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 111 paragrafi 1 pika 1.5 dhe 1. 8 e LPP-së, lidhur me nenin 4. 1. 26, pasi që i njëjti është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Sa i përket pretendimeve të OE ankues se Operatori i shpërblyer me kontrate nga ana e MI-se ka paraqitur dokumentin e gjykatës të falsifikuar atëherë OSHP konform nenit 130 pika 3 e LPP-se do ta njoftoj MPB-në që ti vërtetoj këto pretendime, pasi që në ankesën e mëparshme nuk ka ekzistuar ndonjë pretendim në lidhje me falsifikimin e ndonjë dokumenti.

Sa i përket kërkesës së Operatorit Ekonomik Ankues që OSHP ta anuloj vendimin me numër 460-461 /16, paneli shqyrtues sqaron se pretendimet e tanishme ankimore të shqyrtuara në këtë vendim janë të ndryshme nga pretendimet që ka ngritur OE ankues në ankesën 460/16 dhe me vendimin 460-461 /16 paneli shqyrtues në mënyrë meritore ka dhënë përgjigje për ato pretendime pasi që OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit është i pa përgjegjshëm dhe për shkak të mungesës dëshmimit të interesit Juridiko Material konform nenit 11 par.1 pika 1 deri në pikën 8, lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së, dhe

se në asnjë rrethanë edhe po të kthehej ky aktivitet në rivlerësim i njëjti nuk do shpallej fitues i këtij aktiviteti të prokurimit pasi që numrin e kopjeve të dosjes së tenderit nuk e ka dorëzuar konform LPP-së.

Sa i përket kërkesës së OE ankues që paneli shqyrtues ta anuloj kontratën e lidhur në mes të MI dhe OE fitues për këtë aktivitet të prokurimit, paneli shqyrtues sqaron se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 132 të LPP-së për Anulimin e Kontratës pasi që tani me kontrata është në realizim e sipër por nëse OE ankues mendon se ky vendim i këtij paneli shqyrtues është në kundërshtim me faktet dhe në kundërshtim me LPP-në atëherë konform nenit 119 të LPP-së, OE ankues mund të drejtohet Gjykatës Themelore për shqyrtim të këtij vendimi.

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh faktet e lartcekura, konform nenit 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Ministria e infrastrukturës"

1x1 OE "Botek"Sh.p.k-Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.